



# Ngritja e Kapaciteteve në Udhëheqjen Arsimore

## *Qëllimi i programit:*

Ngritja e kapaciteteve në Udhëheqjen Arsimore ka qenë dhe mbetet një nga prioritetet e Fakultetit të Edukimit në Universitetin e Prishtinës. Fakulteti ka ofruar studime të nivelit Master në fushën e udhëheqjes dhe menaxhimit të arsimit që nga viti 2010 dhe në këtë program janë diplomuar numër i konsiderueshëm i udhëheqësve aktual të shkollave dhe institucioneve të tjera edukative. Por, nevoja për zhvillim profesional në këtë fushë, vazhdon të jetë interes i shumë individëve dhe institucioneve në Republikën e Kosovës.

Në këtë mënyrë, Fakulteti i Edukimit në kuadër të Institutit për Hulumtime dhe Zhvillim të Arsimit (IHZHA), me mbështetjen e GIZ-CDBE, do të ofrojë programin e zhvillimit profesional për ngritjen e kapaciteteve në udhëheqjen arsimore për të gjithë udhëheqësit e interesuar në fushën e arsimit. Trajnimi do të jetë mbështetës i Qasjes së Zhvillimit të Integruar të Shkollës (ISDA) me qëllim të promovimit të një stili horizontal të menaxhimit, i cili mundëson pjesëmarrjen e të gjithë akterëve të shkollës në vendimmarrje.

## *Grupi i synuar i mësimdhënësve /vijuesve:*

Grupi i synuar përfshin mësimdhënësit në shërbim, drejtorët e shkollave (dhe ekipet e tyre të menaxhimit/Këshillin Drejtues të Shkollave, bashkëpunëtorët profesional të shkollës: pedagogun, psikologun apo/edhe koordinatorët e cilësisë dhe aktivat profesionale) dhe stafin e DKA-ve. Programi synon forcimin e udhëheqjes dhe ekipeve në nivel shkolle, zhvillimin e kapaciteteve të tyre për t'u përballur me sfida të reja.

## *Rezultatet e programit:*

Me përvetësimin e këtij programi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Identifikojnë aspektet kryesore arsimore me ndikim të drejtpërdrejtë për një shkollë e cila do të siguronte edukim cilësor;
- Dallojnë parimet e një shkolle të mirë të lidhura me standardet e cilësisë dhe zhvillimin e vizionit afatgjatë;
- Zhvillojnë vision afatgjatë në bashkëpunim me mësimdhënësit, prindërit dhe Këshillin Drejtues të Shkollës;
- Analizojnë sfidat specifike në shkollën ku punojnë;
- Njihen me politikat arsimore dhe zhvillojnë praktika të udhëheqjes për arsim gjithëpërfirës;
- Planifikojnë, zbatojnë, monitorojnë dhe vlerësojnë aktivitetet e tyre të përmirësimit të shkollave; Komunikojnë dhe bashkëpunojnë në mënyrë efektive me stafin administrativ, mësimdhënësit, nxënësit, prindërit, komunën dhe komunitetin;
- Zbatojnë menaxhim të efektshëm të personelit duke përfshirë planifikimin e nevojave të shkollës për personel deri tek vlerësimi i performancës dhe përvaktimi i nevojave për zhvillim profesional;
- Zbatojnë në praktikë mjete administrative për të qenë më të suksesshëm në menaxhimin e kohës, dokumentacionit dhe në udhëheqjen e takimeve;